



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIK OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 25.06.2025.		
Njësi.org. Org. led.	Nr. Br.	Shtokë - Prilog
15-300/01-0036609/25		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Bazuar në nenin 62.3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 64 par.3 dhe 4 të statutit të Komunës nr.01-020/01-50862/18, nenin 18.3 të rregullores për kushtet/kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot: 01-016/01-0030667/22 dhe bazuar në planin e punës dhe në buxhetin për vitin 2025, Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik shpall:

FTESË PUBLIKE
për aplikim në projektin:
NGRITJA DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE
(Mbështetje me pajisje pune)



*Makina profesionale për shtypjen e nxehtë
semi automatike, multicolor*



*Hekur për hekurosje profesionale
me avull 3.5L*



Makina qepëse industriale Iberdek



Makina qepëse industriale Overlluk





Makina qepëse industriale e drejtë



Frigorifer për ftohje/ventilim, 700L, xhama Inox




Mikser për brum, min 10kg



Furrë për pjekje me avull, 73 L, 4 tepsia, 50 kg



*Makinë profesionale full automatike
për prodhimin e petëve*



Kompresor 500L, kw 5.5



Ngritës me kriket për vetura 4000kg – lift



Makinë për ballancim të gomave





*Aparat saldimi CO2, rryma e saldimit: 30 - 250A,
diametri i telit të saldimit: Ø 0.6 - 1.2mm*



Set komplet i veglave për mjeshtër

Të drejtë aplikimi kanë:

- Banorë të Komunës së Podujevës – Biznese ekzistuese dhe Start up.

Kushtet për aplikim:

- Biznesi veprimtarinë ta ushtrojë në territorin e Komunës së Podujevës.
- Të mos ketë obligime financiare të papaguara ndaj Komunës dhe ATK-së.

1) BIZNESET EKZISTUESE

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

- 1) Forma e aplikimit - aplikacioni
- 2) Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit (në emër të cilit është i regjistruar biznesi)
- 3) Deklaratë/Çertifikatë e bashkësisë familjare
- 4) Certifikatën e biznesit me informatat e biznesit (jo më e vjetër se 3 muaj)
- 5) Vërtetimin e tatimit në pronë (dëshmi për pagesën e tatimit)
- 6) Vërtetimin tatimor nga ATK (dëshmi për pagesën e obligimeve)
- 7) Deklaratën për bashkëfinancim 30%



Forma e vlerësimit:

Kriteret	Poena
1 Forma e aplikimit - Projekt propozimi;	0-30
2 Vizita në teren;	0-30
3 Dëshmi për përvojë në veprimtarinë aplikuese (Certifikatë/Vërtetim);	15
4 Biznes në pronësi të Gruas	15
5 Aplikues/e (biznese) që nuk kanë përfituar më parë nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike të Komunës në vitet (2023,2024 dhe 2025).	10

2) START UP**Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:**

- 1) Forma e aplikimit - aplikacioni
- 2) Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit
- 3) Deklaratë/Çertifikatë e bashkësisë familjare
- 4) Vërtetimin e Tatimit në pronë (*dëshmi për pagesën e tatimit*)
- 5) Deklaratën për bashkëfinancim 30%

Forma e vlerësimit:

Kriteret	Poena
1 Forma e aplikimit - Projekt propozimi	0-30
2 Vizita në teren;	0-30
3 Dëshmi për përvojë në veprimtarinë aplikuese (Certifikatë/Vërtetim);	15
4 Aplikuese Grua	15
5 Aplikues/e (familje) që nuk kanë përfituar më parë nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike të Komunës në vitet (2023,2024 dhe 2025).	10

Aplikimi fillon me datë 25.06.2025 dhe mbaron 14.07.2025, Dokumentet për aplikim mund mirren pranë Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik dhe ato duhet të dorëzohen në zyrën e shërbimit të qytetarëve në Komunën e Podujevës.



VËREJTJE:

- Një aplikant nuk mund të dorëzoj më shumë se një aplikacion në këtë thirrje publike, por në një aplikim mund të bëjë kërkesë për tre (3) pajisje nga pakoja e përgjithshme e ofruar e pajisjeve.
- Për Start-Up aplikimi duhet të bëhet nga personat të cilët synojnë të fillojnë biznesin, jo nga persona të tjerë në emër të tyre dhe pas shpalljes si përfitues duhet regjistruar biznesin.
- Për Biznese ekzistuese aplikimi duhet të bëhet nga pronarët/aksionarët e bizneseve siç figurojnë në certifikatën e ARBK-së apo të autorizuarit e tyre.
- Përfituesit do të marrin pjesë (participim) me 30% të vlerës së projektit.
- Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga komuna. *(neni 6.2 i rregullores së subvencioneve)*
- Në bazë të numrit të përgjithshëm të aplikacioneve të pranuar, komisioni gëzon të drejtën të vendos për të subvencionuar bizneset me një, dy apo tre pajisje nga pakoja e përgjithshme e ofruar.
- Në aplikacionet e pranuar evidentohen (aplikues, pronar i biznesit apo familjar të tyre që kanë qenë përfitues në vitet 2023, 2024 dhe 2025 nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike e Komunës), komisioni varësisht nga numri i përgjithshëm i aplikacioneve të pranuar, gëzon të drejtën të vendos lidhur me shqyrtimin apo mos shqyrtimin e aplikacioneve dhe realizimin e vizitave të tyre në teren.
- Aplikacionet me dokumentacion të pakompletuar dhe të dorëzuara pas afateve kohore nuk do të merren parasysh.

Drejtor i DPZHE:

g. Vigan Salihu

